



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.12.2022

MBLEDHJA Nr. 59,
Datë 14.12.2022, ora 13:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e mërkurë, datë 14.12.2022, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 59 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 242, datë 23.09.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kWh në muaj”
2. Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022
3. Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022
4. Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019
5. Mbi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2023
6. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 12.12.2022
7. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI